

KONCEPTET METODOLOGJIKE DHE TEORIKE TË PËRLLOGARITJES SË VARFËRISË NË SHQIPËRI

LEDIA THOMO, INSTITUTI I STATISTIKAVE
lthomo@instat.gov.al

TERANDA JAHJA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
TJAHJA@INSTAT.GOV.AL

RUZHDIE BICI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
rbici@instat.gov.al

BLERTA MUJA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
bmuja@instat.gov.al

Abstrakt

Niveli i jetesës, varfëria dhe mirëqenia, deri në vitin 2012 janë matur nëpërmjet Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ). Në vitin 2016, INSTAT paraqiti një metodë të re të përllogaritjes së këtyre indikatorëve. Deri në vitin 2012 matja e varfërisë është mbështetur në përcaktimin e linjës absolute të varfërisë, bazuar në shpenzimet e konsumit. Nga viti 2016 e në vazhdim matja e varfërisë do të bazohet në linjën relative dhe të të ardhurave vjetore të ekuivalentuara. Ky artikull synon që të jetë informues për këto ndryshime metodologjike të ndodhura. Nisur nga ndryshimet metodologjike, pritet që edhe informacioni të jetë i ndryshëm; gama e indikatorëve do të jetë më e gjerë, fokusuar në përllogaritjet monetare dhe jo monetare të varfërisë, por gjithashtu i krahasueshëm me vendet e tjera të BE-së. Analiza fokusohet në shpjegim përshkrues dhe informues mbi metodologjinë e re, të përfshirë në aktivitetet e INSTAT.

FJALË KYÇE:

Të ardhurat; Niveli i Jetesës; Varfëria;
Linjë relative

1. HYRJE

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) është i vetmi burim ekzistues i të dhënave që mat nivelin e jetesës, varfërinë dhe mirëqenien e familjeve shqiptare, deri në vitin 2012. Kjo anketë mbledh një sërë treguesish monetarë dhe jo monetarë, duke sjellë një larmi informacioni për përdorues të ndryshëm dhe siguron një mjet të domosdoshëm për hartimin e politikave dhe strategjive. AMNJ është kryer për herë të parë në vitin 2002, përsëritur më vonë në vitin 2005, 2008 dhe 2012 (INSTAT, 2013). Nëpërmjet AMNJ synohet matja e varfërisë bazuar në shpenzimet e konsumit, duke përdorur linjën absolute të varfërisë. Të dhënat e AMNJ janë përdorur gjerësisht nga përdorues të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Nga viti 2016 në aktivitetet e INSTAT u përfshi kryerja e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC). SILC mat varfërinë bazuar në të ardhurat gjithsej të individëve apo të familjeve, duke përdorur linjën relative të varfërisë. Metodologjia e SILC bazohet në metodologjinë e Eurostat dhe është e krahasueshme me vendet e tjera të BE-së dhe rajonit (Eurostat, 2017).

2. METODOLOGJIA E PËRLLGARITJES SË VARFËRISË

2.1 METODOLOGJIA E PËRLLGARITJES SË VARFËRISË MONETARE BAZUAR NË SHPENZIMET E KONSUMIT TË NJEF

Përllgaritja e varfërisë, bazuar në shpenzimet e konsumit, u realizua për herë të parë nga AMNJ në vitin 2002. Të dhënat e kësaj ankete u bënë përfaqësuese në nivel katër rajonesh dhe sipas zonës urbane dhe rurale¹. Anketat e tjera, të kryera në vitin 2005 dhe në vitin 2008, kanë ndjekur të njëjtën metodologji. Në vitin 2012, për të pasur një përfaqësim më të madh të të dhënave të anketës (nga 4 rajone në 12 prefektura), u rrit numri familjeve në vrojtim. Rezultatet e këtij vrojtimi japin një pamje të qartë të shpenzimeve, kushteve të banimit dhe varfërisë.

AMNJ përllgarit varfërinë duke marrë për bazë shpenzimet e nevojshme për të siguruar produktet ushqimore dhe një nivel shpenzimesh për nevojat

bazë jo ushqimore. Në këtë mënyrë, përllgaritet linja absolute e varfërisë. Për llogaritjen e kufirit të varfërisë monetare është përdorur metodologjia e "Kostos së Nevojave Bazë" (Ravallion dhe Bidani, 1994).

Kufiri i varfërisë është llogaritur duke përdorur shportën ushqimore që konsumohet nga individët që ndodhen në decilen e dytë deri në të katërt. Duke pasur parasysh rekomandimet e FAO² për konsumin minimal të kalorive sipas moshës dhe gjinisë, dhe duke i përshtatur këto kërkesa për kalori sipas shpërndarjes së popullsisë në Shqipëri në vitin 2001 (Instat, Census, 2001), marrja e kalorive të nevojshme për frymë u përllgarit në 2.288 kalori në ditë. Komponenti jo-usqimor i varfërisë u llogarit duke marrë në konsideratë përqindjen e shpenzimeve për artikujt jo-usqimorë, të atyre familjeve që shpenzonin për artikuj ushqimorë, një vlerë të përafërt me kufirin e varfërisë për ushqim. I llogaritur në këtë mënyrë, kufiri i varfërisë për ushqim (ose kufiri i varfërisë së tejskajshme) u vendos në 3.047 lekë për frymë në muaj, ndërsa kufiri i plotë i varfërisë, i plotësuar me nevojat për artikujt bazë jo-usqimorë, u vendos në 4.891 lekë për frymë në muaj me çmime konstante (2002). Të gjitha llogaritjet e bëra, bazuar në vitet 2005, 2008 dhe 2012, kanë si bazë krahasuese vitin 2002. Për këtë arsye, të gjitha rezultatet janë deflatuar për t'i sjellë në vlera reale, që do të thotë se janë pastruar nga influenca e ndryshimit të çmimeve në periudhat përkatëse. Për llogaritjen e kufirit të plotë të varfërisë është marrë në fillim një kufi varfërie për ushqimet (ose për koston e marrjes së një sasive minimale kalorish) dhe më pas është shtuar për të përfshirë artikujt bazë jo-usqimorë të konsideruar minimalisht të nevojshëm për të jetuar. Pjesa përbërëse jo-usqimore është llogaritur si një mesatare e përpjesës jo-usqimore të shpenzimeve të atyre familjeve që shpenzojnë gati të njëjtën vlerë për ushqim, siç përcaktohet nga kufiri i varfërisë ushqimore.

2.2 METODOLOGJIA E PËRLLGARITJES SË VARFËRISË BAZUAR NË TË ARDHURAT E NJEF³

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës u realizua për herë të parë në vendin tonë në vitin 2016. Qëllimi kryesor i kësaj ankete është studimi, në nivel kombëtar dhe evropian i kushteve të jetesës së NjEF-ve, kryesisht lidhur me të ardhurat e tyre. Kjo anketë është burimi bazë për krijimin e statistikave të krahasueshme në lidhje me

1 <http://instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-s%C3%AB-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs/#tab4>

2 FAO: Organizata Botërore e Ushqimit

3 Njese Ekonomike Familjare

shpërndarjen e të ardhurave dhe përjashtimin social në nivel evropian. Anketa EU-SILC realizohet në të gjithë shtetet anëtare të BE-së në baza vjetore të rregullta.

Statistikat mbi të ardhurat, përfshirjen sociale dhe kushtet e jetesës mbulojnë aspektet objektive dhe subjektive të këtyre temave në të dyja aspektet, monetare dhe jo monetare, për NjEF dhe individë. Rezultatet e pritshme do të japin statistika të krahasueshme me vendet e tjera si dhe do të ndihmojnë vendin mbi të dhëna të besueshme në fushën e varfërisë, përjashtimit social dhe të ardhurave familjare, duke ndihmuar në këtë formë politikat në luftën kundër varfërisë. Anketa SILC mbledh dhe analizon dy lloje të dhënash:

- Të dhëna Cross-sectional, që i përkasin një kohe të caktuar ose një periudhe kohore të caktuar me variablat mbi të ardhurat, varfërinë, përjashtimin social dhe kushtet e jetesës
- Të dhëna panel (longitudinal), që kanë të bëjnë me ndryshimet në nivel individual apo familjar, të vërejtura periodikisht gjatë një periudhe katërvjeçare.

Meqenëse anketa SILC përmban të dhëna panel, kampioni për çdo vit përbëhet nga katër pjesë, të cilat mund të jenë në studim për 1-4 vjet. Çdo pjesë e veçantë mbetet në studim për katër vjet; çdo vit, ¼ e kampionit të vitit të kaluar hiqet dhe shtohet një e re.

Sipas metodologjisë për matjen e varfërisë, linja e varfërisë llogaritet në bazë të konceptit relativ (i varfër në raport me të tjerët) dhe përcaktohet si i tillë në 60% e medianës së të ardhurave disponibël (për individ) të NjEF të ekuivalentuara, duke përdorur shkallën e ekuivalentuar të OECD të modifikuar. Të ardhurat gjithsej të disponueshme të NjEF konsiderohen të ardhurat gjithsej neto (të ardhurat mbas taksave dhe sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore) të marra nga të gjithë anëtarët e NjEF.

Nëpërmjet SILC, të ardhurat disponibël të ekuivalentuara për individë, janë konsideruar të ardhurat gjithsej disponibël të NjEF mbasi janë ndarë sipas shkallës së modifikuar të OECD. Vërehet se, në shpërndarjen për person është sugjeruar që secili anëtar i NjEF zotëron të njëjtat të ardhura që korrespondojnë me të ardhurat ekuivalente të disponueshme të NjEF. Kjo do të thotë që secili anëtar i NjEF gëzon të njëjtin nivel jetese. Rrjedhimisht, në shpërndarjen e të ardhurave për person, të ardhurat që i atribuohen çdo personi nuk përfaqësojnë pagën, por një tregues të nivelit të jetesës. Të gjitha vlerat e të

ardhurave llogariten në baza vjetore dhe agregohen në nivel NjEF.

Metodologjia e SILC është komplekse dhe merr parasysh të njëjtën formë përllgaritjeje sikurse referohet në manualin metodologjik të Eurostat (Eurostat, 2017). Gjithsesi përshtatjet dhe ndryshimet janë bërë të lidhura me specifikat e vendit që kryen anketën. Kjo lidhet me përllgaritjen e të ardhurave bruto dhe neto, ku ndryshon sistemi i taksimit dhe sigurimit, apo specifika të tjera lidhur me transfertat, pagesat sociale dhe pensionet.

Të ardhurat disponibël të ekuivalentuara përllgariten si raport i të ardhurave disponibël gjithsej të një NjEF me madhësinë e ekuivalentuar të saj. Madhësia e ekuivalentuar e NjEF i referohet shkallës së modifikuar të OECD-së (OECD, 2008) dhe përllgaritet duke marrë parasysh numrin e të rriturve në NjEF (14 vjeç e lart) dhe të fëmijëve nën 14 vjeç. Anëtar i parë i NjEF, 14 vjeç e lart, numërohet si 1 person, personat e tjerë të moshës 14 vjeç e lart numërohen si 0,5 persona, ndërsa çdo anëtar i familjes që është 13 vjeç ose më i vogël numërohet si 0,3 persona.

Saktësisht funksioni për peshën në familje do ishte i formës:

$$P_{OECD} = 1A + 0.50A + 0.3F$$

Të ardhurat e NjEF me dy të rritur dhe dy fëmijë nën 14 vjeç janë ndarë me një peshë prej $1 + 0.5 + 2 * 0.3 = 2.1$; të ardhurat e NjEF me 2 të rritur ndahen me peshë $1 + 0.5 = 1.5$; të ardhurat e një NjEF me 2 të rritur dhe 2 fëmijë të moshës 14 vjeç e lart ndahen me $1 + 0.5 + 2 * 0.5 = 2.5$, etj.

Të ardhurat disponibël vjetore të NjEF pjesëtohen me madhësinë e NjEF së ekuivalentuar për të përfutur të ardhurat disponibël të ekuivalentuara për frymë dhe renditen nga vlera më e ulët tek vlera më e lartë.

Nga SILC linja përllgaritet duke marrë për bazë atë që njihet si linja relative e varfërisë, që përdoret gjerësisht si linja zyrtare për matjen e varfërisë në vendet evropiane, 60% e medianës së të ardhurave/frymë disponibël të ekuivalentuara. Në këtë mënyrë përcaktohen edhe personat që bien nën nivelin e varfërisë, si gjithë ata individë për të cilët të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara janë nën nivelin e linjës së varfërisë.

Kjo përbën edhe linjën e varfërisë monetare.

Tabela 1: Ndryshimet midis AMNJ dhe SILC

	AMNJ	SILC
Kampioni	Përfaqësues në 4 rajone dhe e fundit në nivel 12 qarqesh	12 qarqesh dhe 3 rajone
	Jo panel	panel
	Cross sectional	Cross sectional dhe longitudinal
Pyetësi	Pyetësor familjar dhe individual për të gjithë pjesëtarët (me përjashtim të seksionit të punësimit dhe komunikimit)	Pyetësor familjar dhe individual për të gjithë pjesëtarët e familjes 16 vjeç+
	Standard dhe i krahasueshëm në vite	Standard për variablat e detyrueshëm. Krahasueshmëri variablash dhe individësh. Një modul i ri çdo vit
Varfëria monetare	Linja absolute bazuar në shpenzimet e konsumit	Linja relative bazuar në të ardhurat e ekuivalentuara
Varfëria jo monetare	Nevojat bazë të paplotësuara	Privimi material
Periodiciteti	Çdo tre vjet	Vjetor
Krahasueshmëria	Jo e krahasueshme me vendet e BE	E krahasueshme me vendet e BE

3. KRAHASIMI NDËRMJET SILC DHE AMNJ

Ekzistojnë një sërë diferencash dhe ndryshimesh metodologjike midis dy anketave dhe si rrjedhojë, sjellin pritshmëri të ndryshme në variabla dhe tregues, siç shihet në Tabelën 1.

4. KONKLUZIONE

Ekzistojnë ndryshime të rëndësishme në hartimin, kampionimin, metodologjinë e llogaritjes si dhe indikatorët e prodhuar nga të dy burimet. Anketa e SILC do të jetë një risi dhe një pasuri informacioni duke mundësuar edhe krahasueshmërinë në vite, por edhe me vendet e Evropës.

Dy burimet e informacionit nuk kanë bazë krahasimi pasi nëpërmjet AMNJ përllogaritet linja absolute e varfërisë dhe ndërmjet SILC përllogaritet linja relative. Të dy anketat janë multidimensionale për nga gama e indikatorëve që përllogariten dhe nga informacioni që mbledhin. Qëllimi i të dyjave është të përllogaritin mirëqenien, nivelin e jetesës dhe varfërinë. Gjithsesi, përdoruesit e ndryshëm që përdorin këto dy burime duhet të marrin parasysh që nuk ka bazë krahasuese midis të dyjave. Ndryshimet

në metodologji janë thelbësore dhe indikatorët e prodhuar, si për shembull varfëria absolute dhe relative, janë dy koncepte të ndryshme, ndonëse të dy masin varfërinë.

BIBLIOGRAFIA

Eurostat (2017), EUROPEAN COMMISSION, Directorate F: Social Statistics, Unit F-4: Quality of life DocSILC065 (2017 operation), Methodological guidelines and description of EU-SILC target variables, 2017 operation (Version may 2017);

<http://instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-s%C3%AB-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs/#tab4>.

INSTAT,(2013),Shqipëria: Trendi i varfërisë 2002-2005-2008-2012 http://instat.gov.al/media/2065/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses__2012_rishikuar.pdf;

OECD (2008), "Growing Unequal? Income Distribution and Poverty in OECD Countries (2008)", OECD, Paris.

Ravallion M. and Bidani B. (1994), "How Robust Is a Poverty Profile?", The World Bank Economic Review